Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

P V
L V

Plani i Veprimit për zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave

Republika e Kosovës
Prill 2013

Kjo faqe është lënë me qëllim e zbrazët

Përmbajtja

Shkurtesat dhe akronimet 3
Hyrje 5
Qëllimi 5
Metodologjia 6
Buxheti 6
Korniza ligjore dhe e politikave 6
Ligjet ekzistuese që do t'i nënshtrohen plotësim-ndryshimit: 7
Ligjet e reja: 7
Aktet nënligjore (plotësim-ndryshim dhe hartim): 7
Kodet e etikës: 7
Dokumentet e politikave: 7
Marrëveshjet ndërkombëtare 8
Marrëveshjet ndërkombëtarë për përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e riatdhesimit: 8
Llojet e statistikave 8
Trajnimet 9
Anëtarësimi në institucionet ndërkombëtare dhe iniciativat rajonale 10
Tabela e veprimeve 12

Shkurtesat dhe akronimet

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKI	Agjencia Kosovare e Inteligjencës
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ASYCUDA	Sistemi i Automatizuar për të Dhënat Doganore
ASHMDHP	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
BE	Bashkimi Evropian
BMS/SMK	Sistemi për Menaxhimin e Kufirit
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (PK)
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (MPB)
DHTQNJ	Drejtoria Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore (PK)
EASO	Zyra Mbështetëse Evropiane për Azil
EMCDDA	Qendra Evropiane për Monitorimin e Drogës dhe Varësisë nga Droga
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
EUROJUST	Njësia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim Gjyqësor
EUROPOL	Policia e Bashkimit Evropian
FRONTEX	Agjenci e Bashkimit Evropian për Kufij
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
ILECU	Njësia Koordinuese për Zbatimin për Zbatimin Ndërkombëtar të Ligjit
INTERPOL	Policia Ndërkombëtare
KE	Komisioni Evropian
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPIS	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
LHBT	Komuniteti Lesbik, Homoseksual, Biseksual dhe Transseksual
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MARRI	Iniciativa Rajonale për Migracion, Azil dhe Refugjatë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MM	Marrëveshje e Mirëkuptimit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë

NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare (MF)
ONAC	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pikëkalim Kufitar
PSO	Procedurë Standarde e Operimit
PSH	Prokuroria e Shtetit
PV	Plani i Veprimit
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
QKRC	Qendër Komunale për Regjistrim Civil
RAE	Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian
ZKGJC	Zyra Komunale e Gjendjes Civile
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Hyrje

Ky plan veprimi adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse kriteret e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave dhe rekomandimet e dala nga raporti i parë vlerësues i Bashkimit Evropian për zbatimin e Udhërrëfyesit. Plani përfshin aktivitete që janë nën përgjegjësinë e të gjitha institucioneve vendore përgjegjëse për zbatimin e kritereve dhe të rekomandimeve.

Më 14 qershor 2012, Komisionerja e Bashkimit Evropian për Punë të Brendshme, znj. Cecilia Malmström ia ka dorëzuar Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave Qeverisë së Kosovës, respektivisht Ministres së Integrimit Evropian znj. Vlora Çitaku, dhe Ministrit të Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi, si dhe anëtarëve të tjerë të delegacionit të Kosovës të cilët përfaqësonin nivelet e ndryshme të qeverisjes së vendit. Në po këtë ditë është mbajtur edhe Takimi i parë i Zyrtarëve të Lartë (TZL), në të cilin palët janë dakorduar mbi hapat e mëtutjeshëm.

Në shtator 2012, Kosova ka dorëzuar raportin e parë të gatishmërisë dhe një vlerësim gjithëpërfshirës mbi përafrimin e legjislacionit relevant vendor me acquis-në e BE-së. Pas këtij raporti ka pasuar një vizitë e misionit faktmbledhës të BE-së (të përbërë nga ekspertë të KE-së dhe Shteteve Anëtare), të cilët kanë qëndruar në Kosovë më 20 – 22 tetor 2012, dhe të cilët kanë vlerësuar zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizim të Vizave. Pas kësaj, ekspertët e misionit faktmbledhës dhe zyrtarët e Komisionit Evropian, në bashkëpunim me EULEX-in, kanë hartuar raportin e parë të BE-së mbi zbatimin e Udhërrëfyesit. Ky raport është publikuar në Takimin e dytë të Zyrtarëve të Lartë, të mbajtur më 12 shkurt 2013, në Prishtinë.

Qëllimi

Qëllimi i këtij plani është që të përmbledh kriteret që përmban Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave, të publikuar me 14 qershor 2012, dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, të publikuara me 12 shkurt 2013. Plani rreshton krah për krah kriteret dhe rekomandimet e lartpërmendura, si dhe përmban veprime konkrete për përmbushjen e tyre dhe indikatorë matës, të cilët do të shfrytëzohen për të monitoruar zbatimin e kritereve dhe rekomandimeve. Gjithashtu janë identifikuar në mënyrë të qartë dhe të hollësishme institucionet përgjegjëse dhe ato përkrahëse, afatet kohore, si dhe buxhetin shtesë për të zbatuar këto kritere dhe rekomandime.

Institucionet përgjegjëse dhe ato përkrahëse janë përgjegjëse për zbatimin e kritereve dhe rekomandimeve, në bashkëpunim të ngushtë mes vete dhe në koordinim me partnerët relevantë ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë, posaçërisht me Komisionin Evropian, Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX-in dhe me projektet përkrahëse.

Indikatorët e listuar do të zbatohen gjatë vitit 2013, të gjitha resurset e nevojshme njerëzore, teknike dhe financiare do të jenë në dispozicion për zbatimin e tyre, bazuar kjo në përkushtimin dhe vullnetin e plotë politik të Republikës së Kosovës për zbatimin e Udhërrëfyesit. Prandaj presim përkushtim të njëjtë nga akterët e tjerë të cilët luajnë rol të rëndësishëm, qoftë në zbatimin e e zbatimit të kritereve dhe rekomandimeve apo në përkrahjen e zbatimit të tyre.

Monitorimi i këtij plani do të bëhet në baza të rregullta, me ç'rast nga përfaqësuesit e lartë të institucioneve bartëse dhe përkrahëse do të kërkohet të monitorojnë punën e stafit të tyre, si dhe do të kërkohet që të

raportojnë tek instancat relevante. Raportimi gjithashtu do të jetë i rregullt në afate të përcaktuara me partnerët tanë ndërkombëtarë, respektivisht me përfaqësuesit e Komisionit Evropian.

Metodologjia

Ky plan i veprimit është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët relevantë, vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët janë të angazhuar në fushat që mbulohen nga procesi i liberalizimit të vizave, e që në përgjithësi i takojnë fushës së sundimit të ligjit dhe respektimit e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Puna në hartimin e këtij plani ka filluar menjëherë pas takimit të zyrtarëve të lartë të Republikës së Kosovës dhe të Komisionit Evropian, të mbajtur në Prishtinë më 12 shkurt 2013. Drafti i parë është përgatitur nga Ministria e integrimit Evropian, me ç'rast është siguruar një qasje e njëjtë me atë të hartimit të Panit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe për të siguruar që obligimet e marra nga ky proces do të bashkërendohen me procesin e liberalizimit të vizave, si dhe anasjelltas.

Plani përbëhet nga pjesa narrative dhe tabela e veprimeve. Përderisa e para përmbledh shkurtimisht përmbajtjen e planit, kjo e fundit përmban gjithsej 164 veprime. Veprimet janë të ndara sipas blloqeve, si në vijim:

- Blloku 0: Ripranimi dhe riintegrimi – 28 veprime;
- Blloku 1: Siguria e dokumenteve – 10 veprime;
- Blloku 2: Menaxhimi i kufirit dhe i migracionit – 46 veprime;
- Blloku 3: Siguria dhe rendi publik - 66 veprime; dhe
- Blloku 4: Të drejtat themelore lidhur me lirinë e lëvizjes – 14.

Buxheti

Llogaritja e buxhetit është bërë vetëm për disa kategori, respektivisht vetëm për ato veprime që kërkojnë kosto shtesë, kosto më të lartë apo më specifike, si dhe për ato veprime për të cilat të gjitha mjetet nuk janë të siguruara deri më tani. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave është rreth €19,158,000. Përveç kësaj, një pjesë e konsiderueshme e kostos është e mbuluar me kosto administrative, respektivisht ajo e dedikuar për paga e mëditje, hapësirat e pajisjet ekzistuese, e të cilat tashmë janë të llogaritura në buxhetin e secilit institucion, dhe prandaj nuk janë llogaritur ndaras, por janë evidente si 'kosto administrative'.

Korniza ligjore dhe e politikave

Me qëllim të përmbushjes së kritereve dhe rekomandimeve, ky plan veprimi ka paraparë hartimin dhe plotësim-ndryshimin e azhurnimin e një numri të konsiderueshëm aktesh legjislative dhe dokumentesh të politikave, të cilat përfshijnë të gjitha blloqet. Sa i përket legjislacionit, ai është i ndarë në ligje dhe akte nënligjore. Sa u përket akteve nënligjore, ato përfshijnë udhëzime administrative, procedura standarde operative dhe kode të etikës. Përveç kodeve të etikës, shumica e tyre janë akte nënligjore ekzistuese që do të rishikohen, për të reflektuar ndryshimet në ligjet përkatëse, prandaj shumica e tyre janë listuar sipas fushëveprimit të tyre.

Ligjet ekzistuese që do t'i nënshtrohen plotësim-ndryshimit:

- Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Ligjit për të Huajt;
- Ligji mbi Azili
- Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar;
- Ligji mbi Financimin e Partive Politike;
- Ligji Kundër Diskriminimit.

Ligjet e reja:

- Ligji për Bashkëpunim në mes të Agjencive të MIK-ut;
- Ligji Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë;
- Ligji për Përgjime.

Aktet nënligjore (plotësim-ndryshim dhe hartim):

- Rregullorja për Programin/Fondin për Riintegrim;
- Rregullorja e Punës së Departamentit për Riintegrim;
- UA për Marrjen e Shenjave të Gishtërinjve;
- UA dhe PSO për zbatimin e Ligjit të plotësuar-ndryshuar për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Legjislacioni sekondar për zbatimin e Ligjit për të Huajt;
- Legjislacioni sekondar për zbatimin e Ligjit për Policinë dhe Inspektoratin Policor;
- UA-të për zbatimin e Ligji për Letërnjoftim Biometrik;
- Një akt nënligjor për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e MIK-ut;
- Një PSO për zbatimin e rregullave vendore për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e ripranimit;
- Akte nënligjore për funksionimin e Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit;
- Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Akte nënligjore në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve;
- Aktet nënligjore për trajnimet e specializuara dhe indikatorët (për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit);
- Aktet nënligjore mbi përmbaruesit privatë;
- Akte nënligjore për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kodet e etikës:

- Kodi i etikës kundër korrupsionit për zyrtarët e përfshirë në politikat e migracionit;
- Kodet e etikës për zyrtarët publikë të përfshirë në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit dhe të krimit të organizuar (për Policinë e Kosovës; për prokurorët; për gjyqtarët; për Njësinë e Inteligjencës Financiare, për Doganat dhe për Agjencinë Kundër Korrupsionit);
- Kodi i etikës për zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale.

Dokumentet e politikave:

- Strategjia dhe PV për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2013 – 2018;

- Strategjia dhe PV për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (rishikim/përditësim);
- Strategjia dhe PV Nacionale për Migracion 2013 – 2018;
- Strategjia mbi Policinë e Udhëhequr nga Inteligjenca;
- Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra (rishikim/përditësim);
- Strategjia dhe PV për të Drejtat e Njeriut (rishikim/përditësim);
- Strategjia dhe PV për Parandalimin e Trafikimit me Armë 2013 – 2017;
- Plani i Trajnimeve të Specializuara Kundër Korrupsionit;
- Programet trajnuese të institucioneve të veçanta për zyrtarët publikë të përfshirë në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit dhe të krimit të organizuar (të AKK-së, PK-së, KPK-së, KGJK, NJIF dhe Doganë).

Marrëveshjet ndërkombëtare

Ky plan parasheh negocimin dhe sipas mundësisë nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtarë si në vijim:
Marrëveshjet ndërkombëtarë për përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e riatdhesimit:

- Marrëveshja për ripranim me Republikën e Kroacisë;
- Marrëveshja për ripranim me Republikën e Estonisë;
- Marrëveshja për ripranim me Republikën e Letonisë;
- Marrëveshja për ripranim me Republikën e Irlandës;
- Marrëveshja për ripranim me Republikën e Italisë;
- Marrëveshja për ripranim me Republikën e Maqedonisë;
- Marrëveshja për ripranim me Republikën e Turqisë, dhe
- Marrëveshja për ripranim me Republikën e Lihtenshtajnit.

Përderisa nuk parashihen (dhe nuk janë kërkuar nga Udhërrëfyesi) në kuadër të Bllokut për Sigurinë e Dokumenteve, marrëveshjet ndërkombëtare për menaxhimin e kufirit janë paraparë në Bllokun për Menaxhimin e Kufirit, si në vijim:

- MM për bashkëpunim policor ndërkufitar me Malin e Zi;
- MM për hapjen e PKK-së me Maqedoninë në Stanqiq/Belanovc;
- MM për regjimin e trafikut lokal kufitar me Maqedoninë e nënshkruar, dhe
- Protokolli për kryerjen e kontrollit të përbashkët në trafikun hekurudhor me Maqedoninë;

Në anën tjetër, zhvillimi i marrëveshjeve ndërkombëtare është përfshirë si një nga masat më të rëndësishme në kuadër të Bllokut për Sigurinë dhe Rendin Publik, ku kësi lloj marrëveshjesh pritet të nënshkruhen si në listën në vijim:

- Marrëveshje për transferimin e dëshmitarëve të mbrojtur;
- Marrëveshje me Shtetet Anëtare dhe shtetet tjera të interesuara, sa i përket shkëmbimit të informatave strategjike dhe operacionale në zbatim të ligjit, si dhe
- Marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Llojet e statistikave

Plani i veprimit për liberalizim të vizave merr parasysh kërkesat për prodhimin e statistikave të rregullta që dalin nga Udhërrëfyesi për Liberalizim të Vizave të cilat do të ndahen me Komisionin Evropian, EULEX-in,

Shtetet anëtare të BE-së si dhe në raste të veçanta me organizata të specializuara. Raportet statistikore do të hartohen në afate kohorë të rregullta dhe në koordinim të ngushtë me institucionet e lartpërmendura.
.
Për këtë arsye qeveria e Kosovës do të hartojë dhe komunikojë statistika për ripranim dhe riintegrim tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it.

Sa i përket bllokut të parë, respektivisht sigurisë së dokumenteve Qeveria e Kosovës do të hartojë dhe komunikojë statistika mbi numrin e lëshuar të Pasaportave dhe Letërnjoftimeve biometrik tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it.

Në kuadër të bllokut të dytë Qeveria e Kosovës, respektivisht institucionet përgjegjëse do të hartojnë dhe komunikojnë statistika lidhur me masat e kontrollit të kufirit, duke përfshirë numrin e koordinuar të monitorimit dhe operacioneve patrulluese, tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it.

Në kuadër të këtij blloku gjithashtu do të hartojnë dhe komunikojnë statistika për ofrimin dhe lëvizjet e migracionit legal dhe të parregullt si dhe për azilin te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it;

Në kuadër të bllokut të tretë, institucionet vendore do të hartojnë dhe komunikojnë statistika të hollësishme për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it si dhe statistika lidhur me shkëmbimin e informatave në fushën e zbatimit të ligjit, hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta.

Për më tepër, institucionet vendore do të hartojnë dhe komunikojnë statistika për rastet e bashkëpunimit juridik në çështje penale te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it;
Ndërsa në kuadër të pesë indikatorëve matës Qeveria e Kosovës do të raportoj numrin e sakte të kërkesave të refuzuara për ripranim të cilat janë dërguar nga Shtete Anëtare apo shtete e treta, këto të dhëna do të krahasohen me të dhënat e shteteve anëtare dhe vendeve të treta.

Institucionet vendore gjithashtu do te sigurojnë raporte të rregullta, qofshin ato për zbatimin e strategjive, planeve të veprimit, ligjeve etj, të gjitha këto të listuara në tabelën e mëposhtme të veprimeve.

Trajnimet

Në vazhdën e masave që po ndërmerren nga autoritetet relevante, në kuadër të këtij Plani janë paraparë një numër aktivitetesh që kanë të bëjnë me përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve relevante, ndër të tjera, edhe përmes trajnimit. Kështu, në vijim janë të listuara trajnimet e planifikuara, të ndara sipas blloqeve të ULV-së.

Sa i përket ripranimit dhe riintegrimit, janë paraparë trajnimet si në vijim:

- Trajnim rreth riparimit për nivelin qendror;
- Trajnim rreth re-integrimit të personave të riatdhesuar, në nivelin qendror dhe lokal (përfshirë trajnimet rreth përdorimit të bazës së të dhënave për riintegrim, për zhvillimin dhe monitorimin e politikave, zhvillimin e planeve të biznesit etj)

Për më tepër trajnime janë paraparë edhe sa i përket Bllokut për Sigurinë e Dokumenteve, ku ato kryesisht konsistojnë në trajnimet e ofruara për stafin e gjendjes civile dhe regjistrimit civil në nivel lokal dhe atë qendror.

Gjithashtu janë paraparë trajnime në fushën e MIK, si në vijim:

- Trajnim për zyrtarët e angazhuar në MIK rreth analizës së rrezikut;
- Trajnim për zyrtarët e angazhuar në MIK rreth luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Trajnim për zyrtarët e angazhuar në Qendrën Kombëtare për Menaxhim të Kufirit;

Gjithashtu janë paraparë trajnime për adresimin e kritereve rreth migrimit dhe azilit, si në listën në vijim:

- Trajnim për stafin e DSHAM rreth përdorimit të bazës së të dhënave të integruar;
- Trajnim për stafin e DSHAM rreth luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, dhe
- Trajnim për stafin e angazhuar në çështjet e migracionit rreth luftimit të korrupsionit.

Trajnimet në fushën e azilit, janë paraparë si në vijim:

- Trajnime rreth çështjeve që kanë të bëjnë me azilin për zyrtarët relevantë;
- Trajnime anti-korrupsion për zyrtarët e përfshirë në çështjet e ndërlidhura me azil, dhe
- Trajnim për gjyqësorin në lidhje me përmbajtjen e legjislacionit për azil;

Një numër i konsiderueshëm trajnimesh janë paraparë edhe në Bllokun e Sigurisë Publike dhe Rendit, të përfshira në Plan si në listën në vijim:

- Trajnim i zyrtarëve policorë, zyrtarëve doganorë, zyrtarëve të NJIF, prokurorëve dhe gjykatësve në fushën e luftimit të shpëlarjes së parave;
- Trajnim i specializuar për prokurorë në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Trajnim i specializuar për gjyqtarë në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Trajnim i specializuar i zyrtarëve doganorë në luftimin e krimit të organizuar;
- Trajnim i zyrtarëve policorë rreth metodave të policimit të udhëhequr nga inteligjenca si dhe trajnime tjera të specializuara për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Programet trajnuese të zhvilluara për AKK, PK, KPK, KGJK, NJIF dhe Doganat në fushën e luftimit të korrupsionit;
- Trajnim i prokurorëve dhe gjyqtarëve rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, dhe
- Implementimi i programit trajnues për zyrtarët e përfshirë në mbrojtjen e të dhënave personale.

Mekanizmi i trajnimeve është paraparë edhe në kuadër të Bllokut të të Drejtave Themelore lidhur me Lirinë e Lëvizjes, si në listën në vijim:

- Trajnimet e prokurorëve dhe gjyqtarëve rreth legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve

Anëtarësimi në institucionet ndërkombëtare dhe iniciativat rajonale

Institucionet e Republikës së Kosovës në vazhdimësi kanë për qëllim anëtarësimin në organizata dhe institucionet rajonale dhe ndërkombëtare, me rëndësi të veçantë në procesin e liberalizimit të vizave janë organizatat e listuara në udhërrëfyesin e 14 Qershorit. Sidoqoftë, për shkaqe politike, për institucionet Kosovare anëtarësimi në këto organizata është mjaft i vështirë. Për të sigurua qasje proaktive nga institucionet

Kosovare janë planifikuar veprime dhe indikatorë konkretë për anëtarësim në këto organizata dhe për këtë qëllim qysh më herët por edhe në vazhdimësi do të kërkohen rrugë bashkëpunimi dhe do të hulumtohen modalitete të bashkëpunimit me këto organizata, institucione apo nisma rajonale.

Në këtë aspekt, në bllokun e dytë fokusi do të jetë i drejtuar drejt bashkëpunimit me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Kufij (FRONTEX) dhe me Zyrën Mbështetëse Evropiane për Azil (EASO) si dhe në iniciativën Rajonale për Migracion, Azil dhe Refugjatë të njohur si MARRI.

Sa i përket bllokut të tretë institucionet vendore kanë mëtuar dhe do të mëtojnë anëtarësimin në organizatat e rëndësishme të BE-së siç janë Policia e Bashkimit Evropian (EUROPOL), Qendra Evropiane për Monitorimin e Drogës dhe Varësisë nga Droga (EMCDDA) dhe Njësinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim Gjyqësor (EUROJUST).

Plani i Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave me BE-në								
Kat.	**Nr.**	**Veprimet**	**Indikatorët**	**Afatet kohore**	**Institucioni përgjegjës**	**Institucionet përkrahëse**	**Buxheti**	**Të tjera**
Ripranimi								
K	1	Të vazhdojë zbatimin e legjislacionit vendor për fushën e ripranimit						
R	1.1	Zbatimi i Ligjit për Ripranim	1. Numri i kërkesave për ripranim nga Shtetet Anëtare të BE-së, bazuar në Ligjin për Ripranim (vetëm në raport me shtetet me të cilat nuk ka marrëveshje bilaterale) 2. Numri i përgjigjeve pozitive ndaj kërkesave për ripranim nga Shtetet Anëtare të BE-së, bazuar në Ligjin për Ripranim (vetëm në raport me shtetet me të cilat nuk ka marrëveshje bilaterale) 3. Numri i përgjigjeve negative ndaj kërkesave për ripranim nga Shtetet Anëtare të BE-së, bazuar në Ligjin për Ripranim (vetëm në raport me shtetet me të cilat nuk ka marrëveshje bilaterale) 4. Numri i kërkesave për ripranim nga shtetet e treta, bazuar në Ligjin për Ripranim (vetëm në raport me shtetet me të cilat nuk ka marrëveshje bilaterale) 5. Numri i përgigjeve pozitive ndaj kërkesave për ripranim nga shtetet e treta, bazuar në Ligjin për Ripranim (vetëm në raport me shtetet me të cilat nuk ka marrëveshje bilaterale) 6. Numri i përgjigjeve negative ndaj kërkesave për ripranim nga shtetet e treta, bazuar në Ligjin për Ripranim	K4 2013	MPB		Kosto administrative	

Kat.	Nr.	Veprimet	Indikatorët	Afatet kohore	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Buxheti	Të tjera
K	2	Të vazhdojë zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese për ripranim dhe, sipas nevojës, të nënshkruajë marrëveshje të reja për ripranim;						
K	2.1	Të zbatohen marrëveshjet ekzistuese bilaterale për ripranim	1. Numri i kërkesave për ripranim nga Shtetet Anëtare të BE-së, bazuar në marrëveshjet bilaterale 2. Numri i përgigjeve pozitive ndaj kërkesave për ripranim nga Shtetet Anëtare të BE-së, bazuar në marrëveshjet bilaterale 3. Numri i përgjigjeve negative ndaj kërkesave për ripranim nga Shtetet Anëtare të BE-së, bazuar në marrëveshjet bilaterale 4. Numri i kërkesave për ripranim nga shtetet e treta, bazuar në marrëveshjet bilaterale 5. Numri i përgigjeve pozitive ndaj kërkesave për ripranim nga shtetet e treta, bazuar në marrëveshjet bilaterale 6. Numri i përgjigjeve negative ndaj kërkesave për ripranim nga shtetet e treta, bazuar në marrëveshjet bilaterale	K4 2013	MPB	MPJ	Kosto administrative	
K	2.2	Të përmirësohet bashkëpunimi me shtetet me të cilat janë nënshkruar marrëveshje bilaterale për ripranim	1. Numri i takimeve të mbajtura me Ambasadat e SHA të BE-së në Prishtinë 2. Numri i cështjeve të adresuara dhe të zgjidhura 3. Numri i çështjeve të adresuara dhe të zgjidhura përmes Ambasadave dhe Konsullatave të Republikës së Kosovës në vendet kërkuese	K4 2013	MPB	MPJ	Kosto administrative	
K	2.3	Të kryhen vlerësime të rregullta mbi zbatimin e marrëveshjeve bilaterale për ripranim	1. Numri takimeve ose formave të tjera të kontaktit të ekipeve të përbashkëta të parapara me marrëveshje bilaterale për ripranim 2. Dy raporte vlerësuese gjashtëmujore për vitin 2013, të hartuara	K4 2013	MPB		15,000.00 €	

Kat.	Nr.	Veprimet	Indikatorët	Afatet kohore	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Buxheti	Të tjera
R	2.4	Të vazhdohet me negociimin e marreveshjeve për ripranim me SHA të interesuara, vendet kryesore të tranzitit dhe vendet e origjinës lidhur me migrimim e parregullt në Kosovë	1. Marrëveshja për ripranim me Republikën e Kroacisë, e nënshkruar 2. Marrëveshja për ripranim me Republikën e Estonisë, e nënshkruar 3. Marrëveshja për ripranim me Republikën e Letonisë, e nënshkruar 4. Marrëveshja për ripranim me Republikën e Irlandës, e nënshkruar 5. Marrëveshja për ripranim me Republikën e Italisë, e nënshkruar 6. Marrëveshja për ripranim me Republikën e Maqedonisë, e nënshkruar 7. Marrëveshja për ripranim me Republikën e Turqisë, e nënshkruar 8. Marrëveshja për ripranim me Republikën e Lihtenshtajnin, e nënshkruar 8. Një vlerësim rreth nevojave për marrëveshje bilaterale me shtete të treta i përfunduar 9. Numri i marrëveshjeve bilaterale të nënshkruara (bazuar në vlerësimin e mësipërm)	K4 2013	MPB	MPJ	20,000.00 €	
	3	Të sigurojë procedura të shpejta dhe efektive për identifikimin dhe kthimin e qytetarëve të Kosovës, shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi të cilët nuk i plotësojnë, ose nuk i plotësojnë tash e tutje kushtet për hyrje, prezencë, ose qëndrim në territoret e një nga shteteve anëtare dhe të lehtësojë kalimin/transitin e personave në frymë të bashkëpunimit;						
K	3.1	Të kryhen me kohë procedurat e identifikimit dhe verifikimit në terren	1. Numri i personave të verifikuar nga DSHAM (në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile) 2. Numri i personave të verifikuar nga ARC (në regjistrat fizikë të gjendjes civile) 3. Numri i personave të verifikuar nga ILECU/PK 4. Numri i kërkesave të përfunduara brenda afatit të paraparë me Marrëveshje bilaterale për Ripranim dhe/ose Ligjin për Ripranim në raport me numrin e kërkesave të pranuara	K4 2013	MPB		Kosto administrative	

Kat.	Nr.	Veprimet	Indikatorët	Afatet kohore	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Buxheti	Të tjera
R	3.2	Të ripranohen nga të gjitha shtetet anëtare shtetasit e Kosovës, shtetasit e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi të cilët nuk i plotësojnë më kushtet për të hyrë dhe qëndruar në ato vende	1. Numri i shtetasve të Kosovës të riatdhesuar 2. Numri i shtetasve të vendeve të treta të ripranuar përmes Kosovës 3. Numri i personave pa shtetësi të ripranuar në dhe përmes Kosovës	K4 2013	MPB		Kosto administrative	
	4	Të sigurojë që procedurat e ripranimit, të kryera përmes kanaleve përkatëse, të funksionojnë në lidhje me të gjitha shtetet anëtare;						
R		I mbuluar në kuadër të Kritereve të mësipërme						
	5	Të fuqizojë kapacitetet e autoriteteve kompetente për procedimin e aplikacioneve për ripranim dhe të ulet numri i kërkesave të pazgjidhura për ripranim;						
K	5.1	Të rritet numri i stafit në institucionet përgjegjëse për ripranim sipas nevojës	1. Numri i personave të punësuar në nivelin qendror	K4 2013	MPB	MPJ	Kosto administrative	
K	5.2	Të ofrohen trajnime të rregullta, sipas nevojës, për institucionet përgjegjëse për ripranim	1. Numri i stafit të trajnuar në nivelin qendror	K4 2013	MPB	MPJ	Kosto administrative	
R	5.3	Të reduktohet numri i kërkesave të pazgjidhura për riatdhesim nga të gjitha shtetet anëtare, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ripranim ose marrëveshjet për ripranim	1. Numri i kërkesave në pritje për ripranim që janë zgjidhur	K4 2013	MPB		Kosto administrative	
K	6	Të sigurojë që kërkesat për ripranim të procedohen në pajtim me rregullat vendore për mbrojtje të të dhënave						
K	6.1	Të qartësohen procedurat për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e ripranimit	1. Një PSO për zbatimin e rregullave vendore për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e ripranimit i hartuar	K3 2013	MPB	ASHMDHP MPJ	Kosto administrative	
K	6.2	Të ngriten kapacitetet institucionale për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e ripranimit	1. Përshrkrimi i vendit të punës për zyrtarin e MPB-së për mbrojtjen e të dhënave personale i miratuar 2. Numri i sesioneve informuese për fushën e ripranimit të ofruara zyrtarit të MPB-së për mbrojtjen e të dhënave personale	K2 2013	MPB	ASHMDHP	Kosto administrative	
K	6.3	Të sigurohet adresimi adekuat dhe me kohë i ankesave ndaj shkeljeve sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale në fushën e ripranimit	1. Numri i ankesave të dorëzuara dhe të adresuara	K4 2013	MPB	ASHMDHP	Kosto administrative	

Kat.	Nr.	Veprimet	Indikatorët	Afatet kohore	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Buxheti	Të tjera
K	7	Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për ripranim tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it.						
R	7.1	Të komunikohen me kohë statistika të hollësishme për ripranim si dhe të përmirësohet shkëmbimi i të dhënave me autoritetet e shteteve anëtare lidhur me nevojat e veçanta të të kthyerve, duke përfshirë viktimat e trafikimit me njerëz	1. Numri i raporteve për ripranim të dërguara Shteteve Anëtare të BE-së (përfshirë personat me nevoja të veçanta) 2. Numri i raporteve për ripranim të dërguara Komisionit Evropian 3. Numri i raporteve për ripranim të dërguara EULEX-it	K4 2013	MPB	MIE MPJ	Kosto administrative	
R	7.2	Të verifikohen statistikat vendore lidhur me riatdhesimin me ato të shteteve anëtare	1. Numri i raporteve statistikore të pranuara nga shtetet anëtare nga kthehen personat e riatdhesuar (në kuadër të vlerësimit të zbatimit të marrëveshjeve bilaterale) 2. Numri i mospërputhjeve të kerkesave për ripranim të identifikuara dhe adresuara	K4 2013	MPB		Kosto administrative	
Riintegrimi								
K	8	Të miratojë dhe zbatojë masat për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të autoriteteve kompetente për riintegrim, procedurat për aplikim dhe vendimmarrje dhe të drejtat dhe obligimet e përfituesve në kuadër të programit të riintegrimit						
K	8.1	Të kompletohet baza ligjore dhe procedurale për funksionimin e Departamentit për Riintegrim	1. Rregullorja e punës së Departamentit për Riintegrim, e miratuar 2. Përshkrimet e vendeve të punës për stafin e Departamentit për Riintegrim, të miratuara 3. Përshkrimet e vendeve të punës për Koordinatorët Rajonalë, të miratuara 4. Përshkrimet e vendeve të punës për zyrtatët komunalë, të miratuara 5. Një udhëzues i hollësishëm për Komunat për zbatimin e politikave për riintegrim i hartuar	K3 2013	MPB	MAPL ZKM	Kosto administrative	
K	8.2	Të kompletohet baza ligjore dhe procedurale për Programin/Fondin për Riintegrim	1. Rregullorja e re për Programin/Fondin për Riintegrim, e miratuar 2. Një udhëzues i hollësishëm për Komunat për shfrytëzimin e Programit/Fondit për Riintegrim i hartuar	K2 2013	MPB	MAPL ZKM	Kosto administrative	

Kat.	Nr.	Veprimet	Indikatorët	Afatet kohore	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Buxheti	Të tjera
K	8.3	Të zbatohen rregullisht dhe në mënyrë adekuate rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente	1. Numri i takimeve dhe vendimeve të marra nga Bordi për Riintegrim 2. Numri i vizitave në terren të kryera nga Departamenti për Riintegrim për vlerësim të zbatimit të përgjegjësive 3. Një raport vlerësues gjashtëmujor për zbatimin e përgjegjësive në fushën e riintegrimit i hartuar	K4 2013	MPB		Kosto administrative	
K	9	Të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për riintegrim, me theks të veçantë mbi raportimin dhe monitorimin, disbursimin dhe decentralizimin e Fondit të Riintegrimit; dhe shtimin e qasjes së të kthyerve, posaçërisht atyre nga minoritetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas në punësim, trajnime profesionale dhe edukim.						
K	9.1	Rishikimi dhe Monitorimi i rregullt i zbatimit të Strategjisë dhe PV për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar	1. Një vlerësim mbi zbatimin e Strategjisë dhe PV gjatë periudhës 2010 - 2012 i përfunduar 2. Rishikimi dhe miratimi i strategjisë dhe planit te veprimit për riintegrimin e personave te riatdhesuar 3. Raporte të rregullta (tremujore) monitoruese mbi zbatimin e aktiviteteve, të hartuara	K4 2013	MPB	MAPL ZKM MPMS MASHT MSH MIE MF MMPH	Kosto administrative	
K	9.2	Të ngriten kapacitetet institucionale për riintegrimin e personave të riatdhesuar	1. Numri i zyrtarëve shtesë të punësuar në Departamentin për Riintegrim 2. Numri i zyrtarëve shtesë të punësuar nëpër Komuna 3. Numri i trajnimeve të ofruara zyrtarëve përgjegjës për riintegrimin e personave të riadhesuar në nivelin qendror dhe atë lokal	K4 2013	MPB	MAPL	10,000.00 €	
R	9.3	Të vendoset sistemi i menaxhimit të rasteve për të përcjellë qasjen e të kthyerve në shërbimet e riintegrimit	1. Baza e të dhënave për riintegrim, e funksionalizuar 2. Numri i sesioneve të trajnimit për përdorimin e bazës së të dhënave	K3 2013	MPB	MAPL	30,000.00 €	

Kat.	Nr.	Veprimet	Indikatorët	Afatet kohore	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Buxheti	Të tjera
R	9.4	Të zhvendoset fokusi nga programi për rintegrim emergjent tek shërbimet e riintegrimit të qëndrueshëm	1. Të kryhet një vlerësim i nevojave për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2. Numri i nxënësve dhe studentëve të riatdhesuar të regjistruara nëpër shkolla dhe universitete 3. Numri i kurseve të gjuhës të ofruara nxënësve dhe studentëve të riatdhesuar 4. Numri i personave të riatdhesuar të përfshirë në trajnime profesionale 5. Numri i planeve të biznesit të hartuara dhe financuara 6. Numri i njësive për banim të përfunduara 7. Numri i personave të riatdhesuar në nevojë të regjistruar në skema pesionale dhe sociale	K4 2013	MPB	MAPL MASHT MSH MPMS MMPH MF MIE	3,000,000.00 €	
R	9.5	Të bëhet zotimi dhe shpërndarja e fondit të riintegrimit	1. Shuma e mjeteve financiare nga Fondi të zotuara dhe shpenuzara nga secila kategori të shërbimeve emergjente për vitin 2013 2. Shuma e mjeteve financiare nga Fondi të zotuara dhe shpenuzara për secilën kategori të shërbimeve të riintegrimit të qëndrueshëm për vitin 2013	K4 2013	MPB	MAPL	Kosto administrative	
R	9.6	Të ofrohen të dhëna financiare transparente lidhur me zotimet dhe pagesat nga ky fond	1. Raporte të rregullta (tremujore) financiare mbi zotimet dhe pagesat nga Fondi, të hartuara	K4 2013	MPB		Kosto administrative	
R	9.7	Të ngritet numri i përfituesve nga programi i riintegrimit	1. Numri i synuar i përfituesve për secilën kategori të shërbimeve i përcaktuar (bazuar në vlerësimin e nevojave për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar)	K2 2013	MPB	MAPL	Kosto administrative	

Kat.	Nr.	Veprimet	Indikatorët	Afatet kohore	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Buxheti	Të tjera
R	9.8	Të ngritet roli i koordinatorëve rajonalë dhe komisioneve komunale për riintegrim në vendimmarrje financiare	1. Përcaktimi i funksioneve dhe detyrave të punës së koordinatorëve rajonalë për riintegrim 2. Përcaktimi i funksioneve dhe detyrave të punës së komisioneve komunale për riintegrim 3. Numri i trajnimeve mbi politikat për riintegrim, të mbajtura 4. Numri i trajnimeve për hartimin e planeve të biznesit, të mbajtura 5. Numri i trajnimeve për raportim, monitorim dhe vlerësim të politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar, të mbajtur	K4 2013	MPB	MAPL Komunat	10,000.00 €	
R	9.9	Të hetohen rastet e mundshme të korrupsionit në menaxhimin e skemave të qeradhënies për personat e riatdhesuar	1. Numri i rasteve për të cilat janë përfunduar hetimet	K3 2013	KPK	PK	Kosto administrative	
K	10	Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për riintegrimin e të kthyerve, te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it.						
R	10.1	Të komunikohen me kohë statistika të hollësishme për riintegrim si dhe të përmirësohet shkëmbimi i të dhënave me autoritetet e shteteve anëtare	1. Numri i raporteve për riintegrim të dërguara Shteteve Anëtare të BE-së 2. Numri i raporteve për riintegrim të dërguara Komisionit Europian 3. Numri i raporteve për riintegrim të dërguara EULEX-it	K4 2013	MPB	MIE MPJ	Kosto administrative	

Kat.	Nr.	Veprimet	Indikatorët	Afatet kohore	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Buxheti	Të tjera
BLLOKU 1: Siguria e dokumenteve								
Dokumentet personale të udhëtimit, letërnjoftimet dhe dokumentet sekondare								
K	11	Të lëshojë dokumente personale biometrike të udhëtimit të lexueshme nga makina (kompjuteri) në pajtueshmëri me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC) dhe standardet e BE-së për shenjat e sigurisë dhe të dhënat biometrike në dokumentet e udhëtimit dhe të bëhen përpjekje për të gjetur mënyra të mundshme të bashkëpunimit, nëpërmes kanaleve përkatëse, me platformën e njohur si Public Key Infrastructure të ONAC-**ut**						
	11.1	Te plotesohet-ndryshohet Ligji mbi Emrat Personal për të mundësuar regjistrimin e emrave në alfabetin cirilik; të sigurohet zbatimi strikt i këtij ligji për të eliminuar ndryshimet e emrave në formë keqpërdorimesh; të verifikohet identiteti i të gjithë atyre që kanë kërkuar ndryshmet në emra	1. Raport vlersues mbi implikimet e zbatimit të alfabetit cirilik në regjistrin qendror të regjistrit civil 2. Regjistri i përgjithshëm civil i avancuar 3. Numri i emrave të rergjstruar në alfabetin cirilik 4. Numri i personave të cilëve iu është ndryshuar emri sipas kërkesës	K4 2013	MPB		50000	
